L I G J
Nr.9170, datë 22.1.2004

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8637, DATË 6.7.2000 “PËR POLICINË ELEKTRIKE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN 8956, DATË 17.10.2002

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8637, datë 6.7.2000 "Për Policinë Elektrike", ndryshuar me ligjin nr.8956, datë 17.10.2002, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:
"Drejtorin e Policisë Elektrike e emëron, liron ose shkarkon nga detyra ministri përgjegjës për sektorin elektroenergjetik. Kryetarët e degëve të policisë elektrike në prefektura emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra nga Drejtori i Policisë Elektrike.".

Neni 2

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1

Në përbërje të Policisë Elektrike krijohet struktura e Policisë Gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.".

Neni 3

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 15/1

Ngarkohet ministri përgjegjës për sektorin elektroenergjetik të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 15 të këtij ligji.".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4127, datë 13.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu